



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET
KËSHILLI BASHKIAK

V E N D I M

Nr. 2 datë 2 01 2026



PËR NJË NDRYSHIM NË VKB NR 116 DATË 17.12.2025 PËR MIRATIMIN E NIVELIT TE PAGAVE DHE SHPERBLIMEVE TE PUNONJËSVE E TE PERSONAVE TE TJERE TE ZGJEDHUR OSE TE EMERUAR TE BASHKISE PERMET DHE TE INSTITUCIONEVE QE VAREN PREJ SAJ PER VITIN 2026

Bazuar në Ligjin Nr.139/2015 datë 17.12.2015 “ Për vetëqeverisjen vendore “ , neni 54 “Detyrat dhe kompetencat e Këshillit Bashkiak”,pika ç, VKM nr 776 datë 19.12.2025“Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi”, referuar shkresës nr. 3757 prot, datë 11.11.2025 për transfertën e pakushtëzuar për vitin 2026, VKB NR.113 datë 17.12.2025“Për miratimin e buxhetit të vitit 2026 dhe numrin e përgjithshëm të punonjësve të Bashkisë, Njësive Administrative dhe institucioneve në varësi të saj, VKN nr 116 datë 17.12.2025”Per miratimin e planit të punës, planit të konusltimeve dhe planit të buxhetit të Keshillit të Bashkise Permet per vitin 2026, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak,

VENDOSI:

- 1.Të zbatohet paga minimale mujore për punonjësit e Bashkisë dhe Njësive të Varësisë në shumën 50.000 (pesëdhjetë mijë) lekë dhe shtesat e tjera mbi pagë.
- 2.Të zbatohet paga minimale mujore në shumën 50.000 (pesëdhjetë mijë) lekë për të gjithë Punonjësit Administrativë që janë trajtuar sipas pikës 11 dhe 12 të VKM NR 328,datë 31.05.2023”Për klasifikimin e funksioneve,grupimin e Njësive të Vetëqeverisjes Vendore,për efekt page dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar ,të nëpunësve civilë e të punonjësve administrative të Vetëqeverisjes Vendore”,ndryshuar me VKM nr 503.
- 3.Të zbatohet niveli i pagave për pozicionet si më poshtë:
 - Pozicioni Shef i Policisë Bashkiake të jetë i njëvlefishëm me pozicionin e Kryeinspektorit klasa III 2 me pagë pozicioni 90.000 lekë në muaj .
 - Pozicioni Polic Bashkiak të jetë i njëvlefishëm me pozicionin e inspektorit klasa IV 3 ,me pagë pozicioni 70.000 lekë në muaj .



-Pozicioni Polic Bashkiak me arsim të mesëm të jetë i njëvlefshëm me pozicionin e specialistit klasa IV 4 me pagë prej 60.000 lekë në muaj .

4.Efektet financiare do të përballohen nga fondi i veçantë i planifikuar në Buxhetin e Vitit 2026.

5.Ngarkohet Titullari i Bashkisë për miratimin e strukturës së Bashkisë me ndryshimet përkatëse.

6.Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria Financë Buxhet,Burime Njerëzore dhe shërbimeve mbështetëse.

7. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, (i ndryshuar).

Sekretari i Këshillit Bashkiak
Aleks TANE



KRYETAR
Anila DHIMITRI

